



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-18930/20 datë:22.09.2020



Npi – 01/226 datë: 30.09.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.09.2020, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 30.09.2020 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, znj.Xhevahire Ramadani, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri; Zyrtar për Informim, Gazmend Ademaj; Praktikantja, znj.Mirjeta Hoxha; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 27.08.2020,
2. Diskutim për caktimin e terminëve për vizitë nëpër Shkolla të anëtarëve të Komitetit,
3. Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 27.08.2020

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.08.2020.**

Pika 2

Diskutim për caktimin e terminëve për vizitë nëpër Shkolla të anëtarëve të Komitetit

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, mendoj se është mirë me bërë vizita nëpër shkolla ku ka nxënës të komunitetit pakicë. Mësimi ka filluar gati qe 2 javë, kështu që ne duhet me u akorduar mirë sepse nuk mund të marrim pjesë i tërë Komiteti për shkak të pandemisë. Duhet ta shohim se si mundemi me vepruar më mirë.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, edhe unë e përkrahu idenë për ti vizituar shkollat. E dimë që në Shitime është e domosdoshme, sepse ka pjesëtar të komunitetit pakicë, por ka edhe në fshatin Gjyrkovc, e pak ka edhe në fshatin Vojnovc.

z.Ibrahim Demiri; Përshëndetje, unë propozoj që për terminët të njoftohen edhe drejtoritë e shkollave ku do të kryhen vizitat. Është mirë me bërë vizitë një grup prej tre anëtarëve të Komitetit.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, unë edhe mos me ardhur nuk ka problem meqenëse unë punoj në atë shkollë.

znj.Fatmire Ferati; I kemi 2-3 ditë si terminë të mundshme, por duhet ta njoftojmë edhe drejtorin e shkollës.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë propozoj që për Shtime ta lëmë terminin për datën 07.10.2020 prej orës 10:00h.

znj.Diarta Vishesella Unë propozoj që për ditën e parë të marrin pjesë: Kryesuesi Rrahman Kadrija, Muhamet Ademaj dhe Xhevahire Ramadani.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, për ditën e dytë propozojë: Kryesuesin Rrahman Kadrija, Fatmire Ferati dhe Diarta Vishesella.

Pika 3

Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, propozojë që për mbledhjen e radhës me raportua në Komitet dikush nga anëtarët e grupit për vizitat e realizuara nëpër shkolla. Në pika të shkurta prezantoj informatën, si gjithmonë ne e kemi përgatitur informatën në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar me kohë, (shih dokumentin).

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, Unë desha ta bëjë një pyetje se a ka aplikuar dikush për sa i përket renovimit të objekteve të banimit?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Jo ende nuk ka filluar aplikimi.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për informatën, lidhur me aktivitetet e zyrës për muajin shtatorë. U tha se në fshatin Gjyrkovc është riatdhesuar një familje ku e falënderoj zyrën për komunitete. Më gëzoi fakti që ka aplikime për bursa për studentë, që këto bursa i ndanë OJQ -“VORAE”. Lidhur me projektet për ndërtim që pritet të vijnë, shpresoj që ti marrin ata që e meritojnë.

Pika 4

Të Ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, u përmendë K.F. ‘Blindona’ desha ta pyes Ibrahimin se çka ka përfituar kjo?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Ne kemi bërë një njoftim publik, për të konkurruar shoqatat, kështu që ne i përcjellim aplikimet deri te Komisioni, ndërsa Komisioni i dërgon te Kryetari.

z.Muhamet Ademaj; Kam një pyetje, se a ka bërë diçka kompania e ujit KUR “Prishtina” lidhur me furnizimin me ujë për lagjen “Eqrem Çabej” në Shtime.

z.Arton Demiri; Tash në këtë kohë ne në këtë lagje kemi ujë të mjaftueshëm. Problemin me ujë e kemi gjatë sezonit veror.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14.50 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija

